

UDHËZIM
Nr.8, datë 3.7.2007

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORIPARIMIT, SIPAS SEKSIONEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”,

UDHËZOJ:

Neni 1

1. Subjektet juridike, për t’u regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit, dhe për të ushtruar veprimtarinë e autoriparimit, në një ose në disa nga seksionet e përcaktuara në këtë ligj, duhet të disponojnë pajisjet, instrumentet, ambientet e nevojshme, si dhe duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas nenit ose neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Neni 2

SEKSIONI A: Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrjnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Grupë riparimi ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;
- Elektrokompresor;
- Kompjutera;
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

II. Instrumentet:

- Lllamba portative me transformator 220 / 24 – 36 volt;
- Diagnostikues për kontrollin e parametrave të punës së motorit;
- Vegla matëse e të kontrollit, për profesionin motorist, xhenerik etj.

III. Ambientet:

- Tetoja me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrit;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen;
- Zyrë për punë administrative;
- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me leje për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, emri i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj;
- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;
- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licençohet subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin, sipas formatit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 3

SEKSIONI B: *Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së karrocerisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove*

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së karrocerisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Gropa ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;
- Elektrokompresor;
- Kompjutera;
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

II. Instrumentet:

- Llamba portative me transformator 220 / 24 – 36 volt;
- Vegla matëse e të kontrollit, për profesionin xhenerik etj.

III. Ambientet:

- Tetoja me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrit;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen;
- Zyrë për punë administrative;
- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes të karrocerisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocerisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj;
- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licençohet;

sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;
- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licençohet subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin, sipas formatit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 4

SEKSIONI C: Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Pajisje ngritëse (mekanike, hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;
- Pajisje për kontrollin e parametrave elektrikë, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;
- Kompjutera;
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

II. Instrumentet:

- Lllamba portative me transformator 220 / 24 – 36 volt;
- Vegla matëse e të kontrollit, për profesionin elektroauto etj.

III. Ambientet:

- Tetoja me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrit;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen;
- Zyrë për punë administrative;
- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;
- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin, sipas formatit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 5

Seksioni Ç: Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Ngritës (mekanikë, hidraulikë ose elektrikë), sipas standardeve teknike;
- Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergencës së gomave;
- Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;
- Pajisje për çmontimin dhe montimin e gomave;
- Elektrokompresor;

- Kompjutera;
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

II. Instrumentet:

- Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave;
- Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave etj.

III. Ambientet:

- Tetoja me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrit;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen;
- Zyrë për punë administrative;
- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;

- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin, sipas formatit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 6

SEKSIONI D: Veprimtaria e blerjes dhe e shitjes së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Kompjutera;
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

III. Ambientet:

- Tetoja me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur për ekspozimin e mjeteve motorike ose rimorkiove, apo të pjesëve të ndërrimit të tyre;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të shiten;
- Zyrë për punë administrative;
- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si

më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje veprimtarie për blerjen dhe shitjen, e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj;
- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;
sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;
- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin, sipas formatit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 7

SEKSIONI DH: Veprimtaria për mbledhjen, depozitimin, shkatërrimin e mjeteve rrugore me motor ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Pajisje për presimin e pjesëve të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, të dala jashtë përdorimit;

- Kompjutera;
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

II. Instrumentet:

- Vegla dhe çelësa të ndryshme, për çmontime mjetesht etj.

III. Ambientet:

- Sipërfaqe për: depozitimin e mjeteve që do të shkatërrohen, sipërfaqe për pjesët e ndërrimit të dala jashtë përdorimit etj.

- Zyrë për punë administrative;
- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje veprimtarie për mbledhjen, depozitimin, shkatërrimin, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj;
- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;
sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

(DPSHTRR) dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;
- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin, sipas formatit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 8

Tarifat e licencimit janë:

- Për leje njëvjeçare, për subjektet juridike, për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, për çdo seksion, është 5 000 (pesë mijë) lekë;
- Për leje mbi një vit, kur kërkohet nga subjekti, është e barabartë me vleftën, që del nga shumëzimi i tarifës njëvjeçare (5 000 lekë) me numrin e viteve që kërkohet leja;
- Për leje njëvjeçare, për disa seksione, kur kërkohet nga subjekti, është e barabartë me vleftën, që del nga shumëzimi i tarifës një vjeçare (5 000 lekë) me numrin e seksioneve që kërkohet leja;
- Për leje mbi një vit, për disa seksione, kur kërkohet nga subjekti, është e barabartë me vleftën, që del nga shumëzimi i tarifës njëvjeçare (5 000 lekë) me numrin e seksioneve dhe me numrin e viteve që kërkohet leja.

Neni 9

Përpara marrjes së lejes së veprimtarisë, subjektet duhet të ngurtësojnë dhe të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, vlerën e garancisë prej 100 000 (njëqind mijë) lekë, për çdo seksion.

Neni 10

1. Përgjegjësi teknik, për të marrë dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

Seksioni A: Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

- Ligjin nr.9573, datë 3. 7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- Udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, sipas seksioneve” e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- Rregullat e sigurimit teknik në punë;

- Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

SEKSIONI B: Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

- Ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- Udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, sipas seksioneve” e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

SEKSIONI C: *Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove*

- Ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- Udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, sipas seksioneve” e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve elektrike, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- Rregullat e sigurimit teknik në punë;

- Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

SEKSIONI Ç: *Veprimtaria e riparimit dhe e mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove*

- Ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- Udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, sipas seksioneve” e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- Rregullat e sigurimit teknik në punë;

- Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

SEKSIONI D: *Veprimtaria e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre*

- Ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- Udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, sipas seksioneve” e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre;

- Rregullat e sigurimit teknik në punë;

- Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

SEKSIONI DH: *Veprimtaria për mbledhjen, depozitimin, shkatërrimin e mjeteve rrugore me motor ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit apo të braktisura*

- Ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- Ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 102;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 252;

- Udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit, sipas seksioneve” e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

- Rregullat e sigurimit teknik në punë;

- Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

2. DPSHTRR-ja organizon kurse kualifikimi, sipas programeve të miratuara nga Ministria, për ngritjen e nivelit tekniko-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi.

3. Përgjegjësi teknik, për t’u pajisur me “Dëshmi aftësie profesionale”, duhet të paraqesë në DRSHTRR:

- kërkesë për pajisje me "Dëshmi aftësie profesionale", ku të përcaktohen seksioni ku do të aplikojë dhe veprimtaria e tij e kryer, nga marrja e diplomës në formën e CV;

- kopje të noterizuara të diplomës;

- certifikatë personale me fotografi;

- dokumentacion teknik justifikues (original ose kopje të noterizuara) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së seksionit përkatës etj.

- vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006;

- vërtetim nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon, për aftësitë fizike, për të kryer veprimtarinë e autoriparimit, sipas seksionit përkatës.

4. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive, sipas seksionit ku kërkon aplikanti, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 11

1. Modelet e regjistrave, sipas seksionit, janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Plotësimi i regjistrave duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.

3. Ruajtja e regjistrave në arkivë duhet të bëhet sipas rregullave të arkivave.

Neni 12

1. Të gjitha subjektet që pajisen me leje veprimtarie, sipas këtij udhëzimi, para fillimit të aktivitetit të përcaktuar në lejen veprimtarisë:

- duhet të bëjnë ndryshimet në vendimin e gjykatës, për veprimtarinë e licencuar;

- duhet të bëjnë ndryshimet në organin tatimor, për veprimtarinë e licencuar;

- duhet të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që ka lëshuar lejen e veprimtarisë, dokumentin e ndryshuar të gjykatës dhe të organit tatimor.

2. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk do të bëjë rinovimin e lejes së veprimtarisë, në rast se subjekti nuk ka bërë depozitimin e ndryshimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 13

1. DRSHTRR-ja, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, lëshon lejet për veprimtarinë që kërkohet, subjekteve që plotësojnë të gjitha kërkesat respektive të përmendura në këtë udhëzim.

2. DRSHTRR-ja, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, u kthen përgjigje subjekteve që nuk plotësojnë të gjitha kërkesat respektive të përmendura në këtë udhëzim.

3. Në rastet kur DRSHTRR-ja nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, leja e kërkuar nga subjektet, konsiderohet e miratuar dhe subjektit i lind e drejta të fillojë veprimtarinë.

Neni 14

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldash

Përgatitur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Datë, më _____._____._____

FORMULARI TIP I AUTODEKLARIMIT

AUTODEKLARIM (do të përbëhet nga tri pjesë)

Institucioni (drejtuar institucionit për të cilin subjekti është i interesuar)

Pjesa e parë (do të përmbajë gjeneralitetet e përgjithshme)

Unë i nënshkruari _____, deklaroj që jam banues në adresë
_____, me seli _____, tel.: _____,
cel.: _____ dhe me dokument identifikimi/nr. i pasaportës
_____.

Deklaroj që jam regjistruar në organet tatimore me nr.NIPT-i _____, me vendim
gjyqate nr. _____, nuk jam në poces falimentimi, nuk jam në poces hetimi dhe as

në poces gjyqësor. Nuk kam asnjë detyrim financiar (ndaj të tretëve) Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve (për subjektet juridike).

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

Pjesa e dytë (informacion i përgjithshëm lidhur me aktivitetin që ka kryer më parë subjekti, me pyetje alternative)

1. Keni licencë të mëparshme PO / JO
Nëse po, specifikoni fushën _____

2.

Pjesa e tretë (përgjegjësia e vetë subjektit në rast se ai nuk ka zbatuar apo ka dhënë informacion jo të saktë, atëherë do të përballlet me ligjin në fuqi për raportim jo të saktë të të dhënave)

Deklaroj

Që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/____

PËR

USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES SË
PJESËVE MEKANIKE DHE TË MOTORIT, TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE
RIMORKIOVE

(SEKSIONI A)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

- Subjektit juridik: _____

- Administrator: _____

- Me seli në: _____

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/____.

(Emri, mbiemri)
D R E J T O R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/____

Për

**USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES SË
KARROCERISË, TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE**

(SEKSIONI B)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

- Subjektit juridik: _____

- Administrator: _____

- Me sili në: _____

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/____.

(Emri, mbiemri)
D R E J T O R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/____

PËR

USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES SË
IMPIANTIT ELEKTRIK, TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE

(SEKSIONI C)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

- Subjektit juridik: _____

- Administrator: _____

- Me seli në: _____

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/____.

(Emri, mbiemri)
D R E J T O R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/____

PËR

USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES SË
GOMAVE, TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE

(SEKSIONI Ç)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

- Subjektit juridik: _____

- Administrator: _____

- Me seli në: _____

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/____.

(Emri, mbiemri)
D R E J T O R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/____

PËR

**USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BLERJES DHE SHITJES, TË MJETEVE
RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE DHE TË PJESËVE TË NDËRRIMIT
TË TYRE**

(SEKSIONI D)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

Subjektit juridik: _____

Administrator: _____

Me seli në: _____

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/____.

(Emri, mbiemri)
D R E J T O R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/____

PËR

USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR MBLEDHJEN, DEPOZITIMIN,
SHKATËRRIMIN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR OSE TË PJESËVE TË TYRE, TË
DALA JASHTË PËRDORIMIT APO TË BRAKTISURA

(SEKSIONI DH)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

Subjektit juridik: _____

Administrator: _____

Me seli në: _____

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/____.

(Emri, mbiemri)

D R E J T O R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

L E J E

Nr. _____ datë ____/____/_____

PËR

USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES SË
PJESËVE MEKANIKE DHE TË MOTORIT, TË KARROCERISË, TË IMPIANTIT
ELEKTRIK DHE TË GOMAVE, TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE
RIMORKIOVE

(SEKSIONI A, B, C, Ç)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor _____ lëshon këtë leje.

I LËSHOHET:

- Subjektit juridik: _____

- Administrator: _____

- Me seli në:

Leja është e vlefshme deri në datën ____/____/_____.

(Emri, mbiemri)
D R E J T O R

MODELI I REGJISTRIT PËR MBLEDHJEN, DEPOZITIMIN, PJSËTIMIN DHE COPËTIMIN E MJETEVE

[illegible]

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I REGJISTRIT PËR VEPRIMTARITË E RIPARIMIT DHE TE MIRËMBAJTJES SE PJESËVE MEKANIKE DHE TE MOTORIT

[illegible]

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I RREGJISTRIT PER VEPRIMTARITE E RIPARIMIT DHE TE MIREMBAJTJES SE KAROCERISE

[illegible]

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I RREGJISTRIT PER VEPRIMTARITE E RIPARIMIT DHE TE MIREMBAJTJES SE GOMAVE

[illegible]

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I RREGJISTRIT PER VEPRIMTARITE E RIPARIMIT DHE TE MIREMBAJTJES SE IMPJANTIT ELEKTRIK

		Gjenealitet e personit dorezues te autorizuar				Te dhena per	Gjenealitet e personit marres te autorizuar	Data e
--	--	---	--	--	--	--------------	---	--------

[illegible]

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I REGJISTRIT PËR NDËRMJETËSIMIN NË SHITBLERJEN E MJETEVE

		Gjenealitet e furnitorit				Të dhëna për	Gjenealitet e blerësit të autorizuar	Data e
--	--	--------------------------	--	--	--	--------------	--------------------------------------	--------

[illegible]

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime. Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkjve shënohen në çastin e marrjes në ngarkim. Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.

MODELI I RREGJISTRIT PER NDËRMJETËSIMIN NË SHITBLERJEN E MJETEVE

		Gjeneralitet e furnitorit				Te dhena per	Gjeneralitet e blerësit të autorizuar	Data e
--	--	---------------------------	--	--	--	--------------	---------------------------------------	--------

[illegible]

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime. Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkjve shënohen në çastin e marrjes në ngarkim. Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.

MODELI I RREGJISTRIT PER SHITBLERJET E PJESËVE TË KËMBIMIT TË MJETEVE

		Gjeneralitet e furnitorit				Gjeneralitet e blerësit te autorizuar	Data e shitjes
--	--	---------------------------	--	--	--	---------------------------------------	----------------

[illegible]

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.